

Tregtia me pakicë
shënon rritje në maj,
produktet ushqimore
me rritjen më të madhe

FAQE 8



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

16 VJET NGA VENDIMI I GJND-SË QË VULOSI SHTETËSINË E KOSOVËS

FAQE 4-5



Kosova ka shënuar të
mërkurën përvjetorin e
opinionit këshillues të
Gjykatës Ndërkombëtare të
Drejtësisë për shpalljen e
pavarësisë, një prej

momenteve më të rëndësishme
në historinë e shtetit tonë dhe
një referencë e rëndësishme në
zhvillimin e së drejtës ndërkombëtare. Duke konstatuar se
shpallja e pavarësisë së Kosovës

nuk ishte në kundërshtim me të
drejtën ndërkombëtare, GjND-ja
më 22 korrik 2010 i dha fund një
prej pretendimeve kryesore
juridike kundër shtetësisë dhe
mëvetësisë sonë f

**BE-ja
KËRKON
PEZULLIMIN
E RRËNIMIT
TË SHTËPIVE
BUZË UJMANIT**

F. 7



**PËRFUNDON VERIFIKIMI
I NËNSHKRIMEVE NË LDK, NUK
DIHET ENDE DATA E KUVENDIT**

F. 3



RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Peshko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

AKTUALE



**A MUND TË JETË BETEJA SHBA-IRAN
PËR HORMUZIN NJË FITORE PËR
RUSINË DHE KINËN?**

F. 2

**WIZZ AIR HAP BAZËN OPERATIVE NË
PRISHTINË, INVESTON RRETH 100
MILIONË DOLLARË**

F. 6

**FSK-ja ANGAZHONET PËR SHUARJEN
E ZJARRIT NË DEPONINË E
MBETURINAVE NË SFERKË TË PEJËS**

F. 6

EKONOMI



**MINISTRIA E FINANCAVE NËNSHKRUAN
GRANT PREJ 5 MILIONË EUROSH ME
KFW-NË PËR INVESTIME NË RRJETIN
E TRANSMISIONIT**

F. 8

**"EKONOMIA PRIVATE E FINANCON
SHTETIN", RAMOSAJ ME MESAZH TË
DREJTPËRDREJTË PËR PUSHTETARËT**

F. 8

SPORT



**DRITA BARAZON NË MALTË NDAJ
FLORIANAS, GJITHÇKA MBETET E
HAPUR PËR NDESHJEN E KTHIMIT**

F. 10

A MUND TË JETË BETEJA SHBA - IRAN PËR HORMUZIN NJË FITORE PËR RUSINË DHE KINËN?

UASHINGTON, 22 KORRIK - Për vite të tëra politikanët në Uashington e kanë parë Azinë kryesisht përmes prizmit të Tajvanit, Detit të Kinës Jugore dhe rritjes së fuqisë ushtarake të Kinës. Pushtimi në shkallë të plotë i Ukrainës nga Rusia vetëm sa e ka përforcuar këtë këndvështrim, duke e konsoliduar Evropën dhe Azinë Lindore si arenat kryesore të konkurrencës gjeopolitike.

Por, ekspertët e sigurisë në Azinë Juglindore po argumentojnë gjithnjë e më shumë se një krizë tjetër, mijëra kilometra larg, në Lindjen e Mesme, mund ta riformësojë balancën rajonale të fuqisë, shumë më shumë sesa Ukraina apo Tajvani. Rëndësia strategjike e Ngushticës së Hormuzit, përmes së cilës kalon rreth një e pesta e naftës së botës, është bërë e pamundur që të injorohet nga qeveritë në mbarë Azinë Juglindore.

Teksa tensionet, që përfshijnë Iranin, kërcënojnë një nga rrugët më të rëndësishme të transportit të energjisë në botë, analistët thonë se pasojat tashmë po ndryshojnë llogaritjet rajonale për sigurinë, diplomacinë dhe aleancat. “Ne tashmë po shohim se ASEAN-i [Shoqata e Kombeve të Azisë Juglindore] po afrohet me Rusinë, jo në aspektin e sigurisë, por për shkak të varësisë nga energjia”, tha për Radion Evropa e Lirë



Lester Joseph Buitizon, analist i inteligjencës për kërcënimet në Aldebaran Threat Consultants, me seli në Manila. Puna e tij përqendrohet në sigurinë ndërkombëtare dhe politikën në Lindjen e Mesme dhe Afrikën e Veriut.

Operacionet ushtarake mes Shteteve të Bashkuara dhe Iranit gjatë ditëve të fundit kanë rikthyer vëmendjen te Ngushtica e Hormuzit.

Irani pretendon se ka kontroll mbi këtë rrugë strategjike të transitit, teksa ShBA-ja thotë se ka kryer sulme ajrore ndaj objektivave në jug të Iranit “për t’i dobësuar më shumë kapacitetet ushtarake iraniane që përdoren për sulme ndaj anijeve tregtare në Ngushticën e Hormuzit”.

Pavarësisht prej pranisë së

madhe ushtarake të ShBA-së, kompanitë e transportit detar vazhdojnë të hezitojnë të kalojnë përmes ngushticës, duke nxjerrë në pah një realitet që shkon përtej fuqisë detare: sfida më e madhe mund të jetë rikthimi i besimit tek operatorët komercialë.

Transporti i naftës përmes Ngushticës së Hormuzit ka rëndësi jetike për Azinë Juglindore, pasi rajoni vazhdon të jetë shumë i varur nga energjia që vjen nga Lindja e Mesme.

Për shembull, Filipinet importojnë më shumë se 90 për qind të naftës së tyre nga Lindja e Mesme, duke bërë që çdo ndërprerje e furnizimit të jetë një shqetësim i menjëhershëm ekonomik dhe politik, e jo thjesht një çështje e largët e politikës së jashtme.

Megjithëse Manila mbetet një nga aleatet më të afërta të Uashingtonit dhe opinioni publik vazhdon ta favorizojë ShBA-në ndaj Kinës, administrata e presidentit Ferdinand Marcos Jr. ka kërkuar ta rrisë qasjen në naftën e papërpunuar ruse dhe ka zgjeruar diskutimet për bashkëpunim afatgjatë në fushën e energjisë.

Për Buitizonin, mesazhi është i thjeshtë. Nëse edhe aleati më i afërt rajonal i ShBA-së detyrohet të bashkëpunojë me Moskën për të garantuar furnizimin me energji, atëherë vendet që kanë politikë të jashtme më neutrale, sikurse Indonezia dhe Malajzia, me gjasë do ta bëjnë këtë edhe më lehtë.

“Nëse Rusia arrin ta riorientojë me sukses ekonominë e saj

drejt Lindjes”, argumentoi ai, “atëherë sanksionet perëndimore bëhen strukturalisht më pak efektive”. Teksa Rusia mund të përfitojë ekonomisht, Kina mund të ketë përfitime diplomatike nga e njëjta situatë. Sipas Vincent Kyle Parada, analist për kërkime në fushën e mbrojtjes në Zyrën për Studime Strategjike Detare dhe Menaxhim të Strategjisë të Marinës së Filipineve, ka pasur një periudhë kur ASEAN-i arrinte të mbante një balancë mes Lindjes dhe Perëndimit: Kina kishte rritje ekonomike, teksa ShBA-ja garantonte sigurinë rajonale.

Sot, tha Parada, ky dallim po bëhet gjithnjë e më i paqartë. Ai tha se kriza me Iranin është dëshmi se siguria ekonomike dhe siguria kombëtare janë bërë të pandashme. “Ndërthurja mes ekonomisë dhe sigurisë është bërë shumë më e madhe sesa ishte 10 apo 20 vjet më parë”, tha Parada për Radion Evropa e Lirë. Ai shtoi se vendimet e fundit të politikës amerikane, përfshirë shkurtimin e ndihmës për zhvillim në rajon, tensionet tregtare dhe ndërhyrjen në Iran, e kanë dobësuar pozicionin e Uashingtonit në mbarë Azinë Juglindore, duke krijuar njëkohësisht mundësi që Kina ta zgjerojë ndikimin e saj ekonomik. “Kina, në fakt, nuk ka nevojë të bëjë asgjë, veçse të presë”, tha ai.

HEGSETH: LUFTA ME IRANIN I KA KUSHTUAR SHBA-së 37.5 MILIARDË DOLLARË

UASHINGTON, 22 KORRIK - Sekretari amerikan i Mbrojtjes, Pete Hegseth, i tha Kongresit më 21 korrik se lufta me Iranin u ka kushtuar Shteteve të Bashkuara 37.5 miliardë dollarë deri më tani, nga pothuajse 29 miliardë dollarë sa ishte vlerësuar në mes të majit. Ai e mbrojti kërkesën e Pentagonit për rreth 67 miliardë dollarë fonde shtesë.

Duke dëshmuar para Komitetit për Ndarje Buxhetore të Senatit, Hegseth dhe gjenerali Dan Caine, shef i Shtabit të Përgjithshëm, thanë se financimi shtesë ishte “urgjent” dhe “i nevojshëm” për t’i mbuluar kostot e operacioneve ushtarake deri në fund të shtatorit.

Senatorja demokrate Jeanne Shaheen vuri në pikëpyetje kërkesën për fonde shtesë, duke argumentuar se

Pentagoni ende ka 75 miliardë dollarë të pashpenzuara dhe pyeti pse po kërkohen më shumë para “në vend se të kërkohet autorizim për transferim” të fondeve.

Hegseth u përgjigj se këto fonde veçse janë alokuar për prioritetet e tjera përfshirë edhe për projektin e mbrojtjes raketore të quajtur “Golden Dome for America” (Kupola e Artë për Amerikën).

Ligjvënësit demokratë dhe republikanë, po ashtu, i kërkuar administratës amerikane më shumë qartësi për strategjinë e saj në Lindjen e Mesme, pasi lufta në Iran nisi në fund të shkurtit me sulmet e ShBA-së dhe Izraelit.

Ndërkohë, Komanda Qendrore e Ushtrisë amerikane (CENTCOM) tha se me “sukses kemi përfunduar” natën e 11-të me radhë të sulmeve më 21



korrik, duke shënjestruar “qendrat operacionale iraniane, aftësitë detare, hangarët e aeroplanëve, ndërtesa ku mbahen dronët dhe infrastrukturën logjistike ushtarake”.

CENTCOM tha se kishin për

qëllim ta dobësonin edhe më shumë aftësinë e Iranit për t’i kërcënuar anijet tregtare në Ngushticën e Hormuzit, pas më shumë se 30 sulmeve ndaj anijeve tregtare gjatë tre muajve të fundit.

Komanda tha se kjo rrugë ujore

mbetet e hapur dhe përsëriti pretendimin se forcat amerikane kanë ndihmuar në lehtësimin e kalimit të rreth 900 anijeve tregtare dhe 450 milionë fuçive naftë të papërpunuar përmes Ngushticës së Hormuzit që nga fillimi i majit.

Ndërkaq, më 22 korrik ushtria iraniane tha se ka kryer sulme ndaj një baze amerikane në Kuvajt. Sipas njoftimit, ushtria iraniane “kreu sulme me dronë orë më parë ndaj depove të municioneve dhe pajisjeve logjistike në selinë e forcave tokësore të ushtrisë amerikane në Kampin Doha, që gjendet në perëndim të Kuvajtit, në kundërpërgjigje të sulmeve të vazhdueshme amerikane ndaj Iranit”.

Ushtria amerikane ende nuk ka komentuar për këtë pretendim të Iranit.

PËRFUNDON VERIFIKIMI I NËNSHKRIMEVE NË LDK, NUK DIHET ENDE DATA E KUVENDIT



PRISHTINË, 22 KORRIK - Ka përfunduar verifikimi i nënshkrimeve të delegatëve të Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) për thirrjen e Kuvendit të Jashtëzakonshëm, në të cilin pritet të kërkohej shkarkimi i kryetarit Lumir Abdixhiku. Por, data se kur do të mbahet ky Kuvend ende nuk dihet. Kështu ka bërë me dije për Radio Dukagjnin, sekretari i LDK-së, Ilir Ferati, i cili tha se aktualisht janë në fazën e përgatitjeve teknike. "Ka përfunduar verifikimi i nënshkrimeve. Tash po presim përgatitjen e pjesëve të tjera të cilat janë teknike, por si sekretariat jemi duke punuar në këtë drejtim në mënyrë që ta kemi të mundshme që sa më shpejt t'i japim drejtim demokratik partisë. Në momentin që jemi të gatshëm e njoftojmë kryetarin, pastaj ai në një afat sa më të shpejtë e bën ftesën për Kuvendin. Nuk ka arsye për shtyrje të Kuvendit dhe, sa kam parë, edhe kryetari është i interesuar që sa më shpejt ta kryejë si proces, për të krijuar njëfarë paqe brendapërbrenda njerëzve të LDK-së", tha ai. Ai ka ritheksuar se në takimin Kurti - Abdixhiku nuk është diskutuar për emra, po për parime. "Ne nuk kemi diskutuar me Vetëvendosjen për pozicione dhe as për emra

në këtë takim. Janë diskutuar parimet të cilat duhen respektuar tutje për ta zhvilluar diskutimin në kuptim të pozicioneve", tha ai. I pyetur se çfarë do të ndodhë nëse Lëvizja Vetëvendosje nuk e mbështet Vjosa Osmanin për presidente, Ferati tha se kjo

është një çështje që i takon Vetëvendosjes dhe se do të trajtohet në kuadër të negociatave ndërmjet partive. "Është çështje e Lëvizjes Vetëvendosje, jo e Lidhjes Demokratike të Kosovës. Është çështje e negociatave. Thash është herët për të folur për

emra. Ende po diskutojmë për parime. Nëse ka rezultat në këtë pjesë, do të flasim për emra", theksoi ai.

Haziri: Beteja e Abdixhikut me nënshkruesit e mocionit duhet të mbetet përballje e kryetarit të katërt të LDK-së me votuesit e tij

Nënkryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Lutfi Haziri, ka reaguar lidhur me zhvillimet e fundit brenda partisë, duke thënë se përplasjet politike rreth mocionit duhet të trajtohen si çështje e kryetarit të partisë, Lumir Abdixhiku, me votuesit e tij. Haziri në rrjetin social "Facebook" ka shkruar se analizat dhe qëndrimet publike të zyrtarëve e aktivistëve të ndryshëm, qoftë

për apo kundër, sipas tij, paraqesin më shumë pozicionime personale sesa shqetësim për të ardhmen e LDK-së. "Beteja e Lumir Abdixhikut me nënshkruesit e mocionit, në emër të kërkesave politike, është dhe duhet të mbetet beteja e kryetarit të katërt të LDK-së me votuesit e tij", ka shkruar Haziri.

Ai i ka kritikuar debatet e ashpra brenda partisë, duke thënë se LDK-ja ka pasur pasoja nga pozicionimet politike që kanë anashkaluar interesat e saj afatgjat. "Bajagi ia kemi parë sherrin pozicionimeve, duke harruar kënd e kemi familje politike, kush janë rivalët politikë dhe pse çdoherë na përsëritet situata e njëjtë", tha ai. Sipas tij, procesi i fundit është nxitur nga tri degë dhe tre kolegë të partisë, ndërsa një pjesë e delegatëve janë ftuar të deklarohen përmes nënshkrimeve lidhur me kërkesën e paraqitur.

Haziri ka bërë thirrje për më shumë përgjegjësi në komunikimin publik, duke kritikuar, siç tha ai, gjuhën e ashpër dhe thirrjet për protesta nga disa aktivistë. "Funksionarët edhe mund të pajtohen, por jo besimtarët në sjelljen e funksionarëve. Koha e ka dëshmuar. Më mirë me thanë, na falni për gabimet e së kaluarës sesa për të vazhduar me gabime", ka shkruar ai.

Nënkryetari i LDK-së ka theksuar se partia ka arritur sukseset më të mëdha kur ka qenë e bashkuar, duke kërkuar ruajtjen e unitetit dhe respektimin e vlerave mbi të cilat është ndërtuar LDK-ja. "LDK ka shkaktuar procese e ka realizuar ëndrra kur ka qenë e bashkuar. Kemi premtuar që jemi besë e shpresë për Republikën. Mbajeni fjalën, bashkëpatriotë. Mos hyni në beteja që nuk janë tuajat", ka thënë Haziri.



UP-ja dhe Ministria e Bujqësisë nënshkruajnë memorandum bashkëpunimi, synojnë forcimin e kërkimit shkencor dhe zhvillimit të sektorit

Prishtinë, 22 korrik - Universiteti i Prishtinës (UP) dhe Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural kanë nënshkruar memorandum bashkëpunimi, me synim thellimin e bashkëpunimit institucional në fushën e kërkimit shkencor, zhvillimit të bujqësisë dhe krijimit të mundësive më të mira

për studentët.

Rectori i UP-së, Arben Hajrullahu, dhe ministri i Bujqësisë, Armend Muja, e vlerësuan marrëveshjen si një hap i rëndësishëm drejt institucionalizimit të bashkëpunimit ndërmjet dy institucioneve dhe realizimit të projekteve të përbashkëta.

Rectori i UP-së, Arben Hajrullahu, tha se po synohet që për studentët të krijohen kushtet adekuate.

Ministri në detyrë i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Armend Muja, tha se nënshkrimi i memorandumit është hap i parë për të dy institucionet drejt bashkëpunimit.





16 VJET NGA VENDIMI I GJND-së QË VULOSI SHTETËSINË E KOSOVËS

Kosova ka shënuar të mërkurën përvjetorin e opinionit këshillues të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë për shpalljen e pavarësisë, një prej momenteve më të rëndësishme në historinë e shtetit tonë dhe një referencë e rëndësishme në zhvillimin e së drejtës ndërkombëtare. Duke konstatuar se shpallja e pavarësisë së Kosovës nuk ishte në kundërshtim me të drejtën ndërkombëtare, GjND-ja më 22 korrik 2010 i dha fund një prej pretendimeve kryesore juridike kundër shtetësisë dhe mëvetësisë sonë

EPOKA E RE**Mal QORRAJ**

Prishtinë, 22 korrik - Përfaqësues të institucioneve të Kosovës kanë kujtuar 22 korrikun 2010, 16-vjetorin e Opinionit Këshillëdhënës të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, e cila konstatoi se miratimi i Deklaratës së Pavarësisë të 17 shkurtit 2008 nuk ka shkelur të drejtën ndërkombëtare.

Në përfundimin e saj, Gjykata konstatoi: "Gjykata ka konkluduar se miratimi i Deklaratës së Pavarësisë të 17 shkurtit 2008 nuk ka shkelur të drejtën ndërkombëtare, Rezolutën e Këshillit të Sigurimit 1244 (1999) ose Kornizën Kushtetuese. Si rrjedhim, miratimi i asaj deklarate nuk ka cenuar asnjë rregull të zbatueshme të së drejtës ndërkombëtare".

Kryeministri në detyrë, Albin Kurti, tha se kjo datë është një

prej momenteve më të rëndësishme në historinë e shtetit tonë dhe një referencë e rëndësishme në zhvillimin e së drejtës ndërkombëtare. "Duke konstatuar se shpallja e pavarësisë së Kosovës nuk ishte në kundërshtim me të drejtën ndërkombëtare, GjND-ja i dha fund një prej pretendimeve kryesore juridike kundër shtetësisë dhe mëvetësisë sonë. Ky opinion riafirmoi një parim me vlerë universale: e drejta ndërkombëtare nuk ekziston për të ruajtur padrejtësinë apo për ta bërë historinë të pakthyeshme, por për të krijuar hapësirë që paqja, liria dhe vetëvendosja demokratike të gjejnë shprehje brenda rendit juridik ndërkombëtar. Kur e drejta interpretohet me integritet, ajo nuk bëhet pengesë për lirinë, por garanci e saj", ka shkruar Kurti në rrjetet sociale.

Ai ka theksuar se për Kosovën ky ishte një moment që forcoi themelet e subjektivitetit tonë

ndërkombëtar. "Për bashkësinë ndërkombëtare, ishte një sqarim i rëndësishëm se e drejta ndërkombëtare nuk ndalon deklaratat e pavarësisë dhe se secili rast duhet të vlerësohet mbi faktet dhe normat që e karakterizojnë. Mbrojtja më e

mirë e kësaj trashëgimie nuk është vetëm ta kujtojmë atë, por ta justifikojmë çdo ditë: me institucione demokratike, me sundim të ligjit dhe me një Republikë që e forcon legjitimitetin e saj përmes punës, zhvillimit dhe përgjegjësisë", ka shkruar Kurti, duke shtuar se opinionin e GjND-së u shpall nga kryetari i atëhershëm i Gjykatës, profesori Hisashi Owada, i cili vitin e kaluar u dekorua nga Universiteti i Prishtinës me titullin e lartë "Doctor Honoris Causa", për kontributin e jashtëzakonshëm akademik, angazhimin jetësor në fushën e drejtësisë

ndërkombëtare dhe promovimin e paqes globale.

Ish-presidentja Vjosa Osmani ka theksuar se 22 korriku 2010 ishte momenti i dështimit të Serbisë në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë (GjND). "Mirënjohje për të gjithë ekipin me të cilin punuam bashkë për këtë rezultat historik për Republikën tonë", ka shkruar Osmani.

Bedri Hamza, kryetar i PDK-së, ka thënë se ky vendim rikonfirmoi se rruga jonë drejt lirisë dhe pavarësisë ishte e drejtë dhe në përputhje me parimet e së drejtës ndërkombëtare. "Gjashtëmbëdhjetë vjet më vonë, Kosova po përballet me një

Thaçi më 22 korrik 2010: Opinioni i GjND-së paraqet një ditë historike për Republikën e Kosovës

"Opinionin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë është përgjigja më e mirë që i është dhënë botës për të drejtën e Kosovës si shtet legjitim dhe legal, si shtet i konsoliduar dhe funksional. Kjo është një përgjigje e drejtë ndërkombëtare ndaj padrejtësive historike që janë bërë ndaj Kosovës. Opinioni i GjND-së paraqet një ditë

historike për Republikën e Kosovës. Kosova e ka ndërtuar bazën e saj legale dhe legjitime, ngaqë drejtuesit e institucioneve të saj kanë qenë të bindur për të drejtën e Kosovës për të qenë shtet i pavarur dhe sovran. Vendimi për shpalljen e pavarësisë më 17 shkurt vetëm u rikonfirmua, u legalizua, u rilegitimua përsëri edhe nga

opinionin e GjND-së, kështu që edhe ky është një moment historik, sepse opinionin e GjND-së u jep mundësi të gjitha vendeve që kanë hezituuar ta njohin Kosovën, që ta marrin këtë hap. Ky vendim i ka hequr të gjitha dilemat", kishte thënë në atë kohë kryeministri Hashim Thaçi, më 22 korrik 2010.

16 VJET NGA OPINIONI KËSHILLIMOR I GJYKATËS NDËRKOMBËTARE TË DREJTËSISË PËR KOSOVËN: TRIUMFI I SË DREJTËS NDËRKOMBËTARE DHE VULOSJA E LEGJITIMITETIT TË SHTETIT TË KOSOVËS



Shkruan: Akademik
Arsim BAJRAMI

Sot, më 22 korrik 2026, Republika e Kosovës shënon 16-vjetorin e Opinioni Këshillimor të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë (GJND), një prej fitoreve më të mëdha juridike dhe diplomatike në historinë e shtetndërtimit të saj. Vendimi i Gjykatës, i shpallur më 22 korrik 2010 në Hagë, përbën një nga dokumentet më autoritative të së drejtës ndërkombëtare që konfirmoi se shpallja e pavarësisë së Kosovës nuk ishte në kundërshtim me të drejtën ndërkombëtare.

Ky opinion nuk ishte thjesht një interpretim juridik. Ai përfaqësoi një moment historik, në të cilin institucioni më i lartë

gjyqësor i Kombeve të Bashkuara rrëzoi argumentin kryesor të Serbisë se Deklarata e Pavarësisë e 17 shkurtit 2008 ishte e paligjshme. Me një shumicë bindëse votash, Gjykata arriti në përfundimin se e drejta ndërkombëtare nuk përmban ndonjë ndalim ndaj deklarave të pavarësisë dhe se deklarata e Kosovës nuk kishte shkelur as të drejtën ndërkombëtare të përgjithshme, as Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së dhe as Kornizën Kushtetuese të UNMIK-ut.

Ky konstatim kishte një peshë të jashtëzakonshme juridike dhe politike. Për herë të parë, organi më i lartë gjyqësor ndërkombëtar e trajtoi në mënyrë të drejtpërdrejtë çështjen e ligjshmërisë së shpalljes së pavarësisë së Kosovës, duke i dhënë fund debatit juridik që Serbia kishte përprjekur ta impononte në arenën ndërkombëtare.

Opinion i GJND-së nuk e "krijoi" shtetin e Kosovës. Republika e Kosovës ishte

shpallur shtet sovran më 17 shkurt 2008 dhe legjitimiteti i saj buronte nga e drejta e qytetarëve të saj për vetëvendosje, nga shpërbërja e ish-Jugosllavisë, nga shkeljet sistematike të të drejtave të njeriut dhe krimet e kryera nga regjimi i Millosheviqit, si dhe nga procesi i administrimit ndërkombëtar pas vitit 1999. Megjithatë, Opinion i GJND-së e vulosi juridikisht këtë realitet dhe e forcoi ndjeshëm pozitën ndërkombëtare të Kosovës.

Pas shpalljes së opinionit, shumë shtete e panë atë si një garanci juridike për të njohur Republikën e Kosovës. Për Kosovën, opinion i u shndërrua në një instrument të fuqishëm diplomatik, i cili u përdor në fushatën për zgjerimin e njohjeve dhe për konsolidimin e subjektivitetit ndërkombëtar të shtetit.

Një element me rëndësi të veçantë është fakti se Gjykata e trajtoi rastin e Kosovës si një rast sui generis, të lidhur ngushtë me rrethanat historike, juridike dhe humanitare që pasuan

shpërbërjen e ish-Jugosllavisë. Kjo e bëri të qartë se opinion i nuk krijonte një precedent automatik për raste të tjera në botë, por njëkohësisht e afirmonte ligjshmërinë e procesit të shtetformimit të Kosovës.

Edhe pas 16 vitesh, Opinion i Këshillimor mbetet dokumenti më i rëndësishëm juridik në mbrojtje të shtetësisë së Kosovës. Në çdo debat ndërkombëtar për statusin e Kosovës, ai përbën referencën më autoritative, sepse vjen nga organi kryesor gjyqësor i Kombeve të Bashkuara. Asnjë zhvillim politik nuk e ka zbehur peshën e këtij opinion i, i cili vazhdon të mbetet pjesë e jurisprudencës moderne të së drejtës ndërkombëtare.

Ky përvjetor është gjithashtu një rast për të kujtuar kontributin e institucioneve të Republikës së Kosovës, të ekipit juridik dhe diplomatik, si dhe të miqve ndërkombëtarë që punuan me përkushtim për paraqitjen e argumenteve para Gjykatës. Ai proces dëshmoi se shtetet e

vogla mund t'i mbrojnë interesat e tyre përmes argumenteve të fuqishme juridike, kur ato mbështeten në parimet e drejtësisë dhe të së drejtës ndërkombëtare.

Sot, 16 vjet më pas, Kosova duhet ta përdorë edhe më fuqishëm këtë kapital juridik në politikën e saj të jashtme. Opinion i GJND-së nuk duhet të mbetet vetëm një sukses historik, por një instrument aktiv në përpjekjet për anëtarësim në organizatat ndërkombëtare, për zgjerimin e njohjeve dhe për forcimin e pozitës së Republikës së Kosovës në sistemin ndërkombëtar.

Më 22 korrik 2010, Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë nuk vendosi vetëm për një deklaratë pavarësie; ajo konfirmoi se lindja e shtetit të Kosovës ishte në përputhje me të drejtën ndërkombëtare. Ky është mesazhi që mbetet aktual edhe sot, 16 vjet më vonë: e drejta ndërkombëtare mund të jetë mbështetësja më e fortë e lirisë, e demokracisë dhe e shtetësisë së Kosovës.



realitet shqetësues: procesin gjyqësor ndaj ish-krerëve të UÇK-së dhe themeluesve të shtetit, ngecjen në procesin e njohjeve të reja, vështirësitë në integrimin ndërkombëtar dhe përkeqësimin e raporteve me aleatët tanë. Vendit tonë i nevojitet një lidhësi që ndërton dhe forcon aleancat, mbron interesat shtetërore dhe sjell rezultate konkrete për qytetarët tanë", ka shkruar

Hamza në "Facebook".

Ish-kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, përmes një postimi në "Facebook", e ka cilësuar vendimin e GJND-së si një nga momentet më të rëndësishme në historinë e shtetësisë dhe shtetndërtimit të Kosovës. Sipas tij, shpallja e pavarësisë më 17 shkurt 2008 u vulos me opinionin këshillëdhënës të GJND-së më

22 korrik 2010, duke konfirmuar shtetësinë dhe të drejtën e Kosovës të fituar me luftën çlirimtare.

Haradinaj theksoi se Kosova duhet të vazhdojë t'i ndjekë vlerat perëndimore dhe ta thellojë partneritetin me miqtë dhe aleatët e saj, veçanërisht me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, si rruga e vetme për arritjen e objektivave shtetërore.

Në fund të postimit ai dha këtë mesazh: "Zoti e bekoftë Kosovën!"

Edhe ambasadori i Kosovës në Japoni, Sabri Kiçmari, ka thënë se ky opinion përbën një nga dokumentet më të rëndësishme juridike në mbështetje të legjitimitetit dhe legalitetit të pavarësisë së Republikës së Kosovës. "Ai konfirmoi se shpallja e pavarësisë ishte në përputhje me të drejtën

ndërkombëtare dhe forcoi më tej pozitën ndërkombëtare të Kosovës, duke shërbyer si një pikë e rëndësishme referimi në zhvillimin e subjektivitetit të saj ndërkombëtar. 16 vjet më pas, ky opinion mbetet një dëshmi e fuqisë së drejtës ndërkombëtare dhe një gur themeli në konsolidimin e shtetësisë së Republikës së Kosovës", ka shkruar Kiçmari në "Facebook".

Kryeprokurori i Shtetit dhe drejtori i ATK-së diskutojnë për thellimin e bashkëpunimit ndërinstytucional

PRISHTINË, 22 KORRIK - Kryeprokurori i Shtetit, Zejnulla Gashi, ka pritur në takim drejtorin e Administratës Tatimore të Kosovës (ATK), Mentor Hyseni. Fillimisht, drejtori i ATK-së, Hyseni, ka uruar kryeprokurorin Gashi për fillimin e mandatit si kryeprokuror i shtetit. Me këtë rast, ata kanë diskutuar për avancimin e bashkëpunimit ndërinstytucional, veçanërisht

në trajtimin efikas të çështjeve të përbashkëta në luftimin e veprave penale të pastrimit të parave, evazionit fiskal, si dhe luftimin e të gjitha formave të tjera të kriminalitetit financiar, me qëllim të forcimit të sundimit të ligjit në Republikën e Kosovës.

Në këtë takim është theksuar edhe nevoja e zbatimit më proaktiv të memorandumit të bashkëpunimit të nënshkruar

ndërmjet Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit dhe Administratës Tatimore të Kosovës, që ka të bëjë me shkëmbimin e informacioneve në kuadër të platformës për hetime penale mbi të dhënat inteligjente, gjë që do të kontribuojnë në luftimin më efektiv të veprave penale që ndërliken me korrupsionin, pastrimin e parave dhe krimin e organizuar.



WIZZ AIR HAP BAZËN OPERATIVE NË PRISHTINË, INVESTON RRETH 100 MILIONË DOLLARË

EPOKA E RE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 22 KORRIK - Kompania ajrore Wizz Air do ta hapë nga nëntori i këtij viti bazën operative në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës "Adem Jashari", duke e bërë Kosovën një nga qendrat e saj të operimit në rajon. Me vendosjen e një avioni Airbus A321neo, investimi pritet t'i rrisë lidhjet ajrore të vendit, t'i zgjerojë mundësitë e udhëtimit dhe të kontribuojë në zhvillimin ekonomik përmes krijimit të vendeve të reja të punës dhe shtimit të kapaciteteve të fluturimeve.

Kryeministri në detyrë, Albin Kurti, mori pjesë në ceremoninë e hapjes së bazës operative të Wizz Air në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës "Adem Jashari". Me këtë rast, kryeministri në detyrë, Kurti, theksoi rëndësinë e vendimit të Wizz Air, për ta vendosur bazën e saj në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës. "Vendimi i Wizz Air për ta vendosur bazën e saj në Aeroportin Ndërkombëtar të



Prishtinës është dëshmi se Kosova po shihet gjithnjë e më shumë si vend i besueshëm për investime, me perspektivë të qartë zhvillimi, si dhe me potencial të madh për t'u integruar edhe më shumë në rrjetet evropiane të transportit, të tregtisë dhe të lëvizjes së lirë të

njerëzve", tha kryeministri Kurti. Ai shtoi se suksesi i këtillë nuk ka ardhur rastësisht, por është, siç tha kryeministri, rezultat i një pune të përbashkët, i përkushtimit institucional, i bashkëpunimit të ngushtë me operatorët ekonomikë e me partnerët tanë ndërkombëtarë, i

shtimit të numrit të pasagjerëve, si dhe i qeverisjes së mirë që e ka ngjallur dhe po e rritë besimin në potencialin që shteti ynë e ka. "Sa më shumë destinacione, operatorë dhe konkurrencë të drejtë të kemi në treg, aq më të përballueshme bëhen biletat për qytetarët tanë. E kur çmimet

ulen, familjet takohen më shpesh, studentët udhëtojnë më lehtë, ndërkaj bizneset krijojnë bashkëpunime të reja", tha kryeministri në detyrë Kurti.

Përfaqësuesi i Wizz Air, Andras Szabo, tha se kompania operon në Kosovë që nga viti 2017 dhe se hapja e bazës në Prishtinë shënon një fazë të re të pranisë së saj në vend. Ai ka bërë me dije se investimi kap vlerën e rreth 100 milionë dollarëve dhe do të shoqërohet me krijimin e 40 vendeve të reja të punës.

Ndërkaq, drejtori i Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës, Gokhan Acikgoz, tha se baza e re e Wizz Air përfaqëson një moment historik për aeroportin dhe për vendin, duke theksuar se investimi do të ndikojë në rritjen e kapaciteteve, përmirësimin e lidhjeve ajrore dhe zhvillimin ekonomik.

Wizz Air do të shtojë edhe tri linja të reja drejt Bruksel Charleroi-t tri herë në javë, Karlsruhe/Baden-Baden katër herë në javë, gjithashtu drejt Zvicrës me tarifa shumë të përballueshme çdo ditë për në Bazel dhe Dortmund - Prishtinë nga fundi i vitit.

FSK-ja ANGAZH OHET PËR SHUARJEN E ZJARRIT NË DEPONINË E MBETURINAVE NË SFERKË TË PEJËS



PRISHTINË, 22 KORRIK - Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK) ka angazhuar njësitë e saj për ndërhyrje në fshatin Sferkë të komunës së Pejës pas shpërthimit dhe përhapjes së një zjarri me përmasa të mëdha në deponinë e mbeturinave të kësaj zone. Sipas njoftimit të FSK-së, pas pranimit të kërkesës nga Qendra e Situatave e Sekretariatit të Këshillit të Sigurisë së Kosovës, Qendra Operative e FSK-së ka bërë vlerësimin e menjëhershëm të

rrezikut dhe kapaciteteve për reagim. "Pas analizës përkatëse, me urdhër të Komandantit të FSK-së, Gjenerallejtënant Bashkim Jashari, janë mobilizuar dhe kanë zbarkuar në terren njësitë e specializuara të Gardës Kombëtare me kapacitetet e saja për intervenim në këtë situatë", thuhet në njoftimin e FSK-së. Operacioni, sipas FSK-së, ka nisur menjëherë me qëllim të izolimit të vatrës së zjarrit, parandalimit të ndotjes toksike

të mjedisit dhe shmangies së pasojave për shëndetin publik. "Njësitë tona po punojnë në koordinim të ngushtë me autoritetet qendrore, lokale, shërbimet e emergjencave civile dhe popullatën lokale për të kthyer situatën në normalitet në kohën më të shpejtë të mundshme", ka njoftuar FSK-ja. Forca e Sigurisë së Kosovës ka theksuar se mbetet e angazhuar për t'u shërbyer qytetarëve të Kosovës në përputhje me detyrat dhe misionin e saj.

Policia nis zbatimin e planit operativ për sigurinë në trafik, me fokus te motoçikletat

Prishtinë, 22 korrik - Drejtoria Rajonale e Policisë në Prishtinë, përkatësisht Njësi i Trafikut të Kryeqytetit, duke u mbështetur në vlerësimet e fundit lidhur me situatën e sigurisë në trafik, ka

filluar zbatimin e një plani operativ për kontroll të shtuar në komunikacion.

Plani ka filluar të zbatohet në fillim të muajit korrik dhe ka për synim rritjen e nivelit të sigurisë

rrugore, me theks të veçantë ndaj ngasësve të motoçikletave. Në këtë operacion deri më sot janë konfiskuar 114 motoçikleta dhe janë marrë masa ndaj 535 ngasësve të motoçikletave.

Ky operacion do të shtrihet në të gjitha rrugët e rajonit të Prishtinës dhe do të vazhdojë deri në momentin kur të vlerësohet se është arritur efekti i dëshiruar në përmirësimin e sigurisë në trafik.



BE-ja KËRKON PEZULLIMIN E RRËNIMIT TË SHTËPIVE BUZË UJMANIT

PRISHTINË, 22 KORRIK - Zyra e Bashkimit Evropian ka kërkuar të ndërpritet rrënimi i shtëpive buzë Liqenit të Ujmanit teksa ka shprehur keqardhje për aksionin e një dite më parë të ndërmarrë nga autoritetet e Kosovës. Sipas BE-së, me rrënimin e shtëpive në Ujman nuk u respektuan “procedurat e rregullta ligjore”.

Blloku evropian tha se aksioni i së martës i autoriteteve të Kosovës u ndërmor në kohën kur banorët kishin nisur procedura gjyqësore brenda afatit 15-ditor të përcaktuar në njoftimet e ndërmarrjes publike “Ibër-Lepenc”. “BE-ja është e shqetësuar për mungesën e respektimit të procedurës së rregullt ligjore në këtë dhe në disa raste të tjera të kohëve të fundit në veri të Kosovës që nga shkurti i këtij viti”, thuhet në reagim.

Ndërmarrja Publike Hidroekonomike “Ibër-Lepenc” tha se 11 shtëpitë e rrënuara ndodheshin ilegalisht në pronën e saj.

Kryeshefi i kësaj ndërmarrjeje, Faruk Mujka, tha se pronarëve u ishte kërkuar më 3 korrik që t'i lironin shtëpitë, por pas moszbatimit të kërkesës, Inspektorati i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, në bashkëpunim me Policinë e Kosovës, nisën zbatimin e vendimit për rrënimin e tyre më 21 korrik. Ndërkaq, BE-ja kërkoi që të



ndërpritin menjëherë të gjitha rrënimet, largimet e detyruara apo marrjet në posedim të pronave, derisa të adresohen shqetësimet lidhur “me procedurën e rregullt ligjore”, duke kërkuar që autoritetet të bashkëpunojnë me banorët dhe komunat e prekura dhe të gjejnë zgjidhje ligjore. “Masat e pakthyeshme të zbatimit në kontekstin e procedurave në zhvillim dhe pretendimeve të kontestuara pronësore ngrenë

shqetësime serioze për sundimin e ligjit”, tha BE-ja, duke shtuar se pret nga Kosova që në përputhje me rrugën evropiane, të adresojë këto shqetësime me urgjencë dhe “veprime të ngjashme të mos përsëriten”.

Ndërkaq Ambasada e Gjermanisë në Prishtinë tha se ndan shqetësimet e shprehura nga BE-ja. “Jemi thellësisht të shqetësuar lidhur me rrëzimin e shtëpive në Ujman”, tha

Ambasada e Gjermanisë, duke kërkuar që të ketë procese të rregullta ligjore. “Ne bëjmë thirrje që veprime të tilla të ndalen menjëherë dhe bëjmë thirrje për transparencë dhe zgjidhje të ligjshme”.

Branimir Mihajloviq, banor i Mitrovicës së Veriut dhe pronar i një shtëpie në Ujman, i tha Radios Evropa e Lirë se vitin e kaluar kishte paraqitur kërkesë për legalizimin e pronës në sistemin e Kosovës

dhe ishte i gatshëm ta paguante qiranë ndaj institucioneve të Kosovës. “Unë i kam të gjitha dokumentet. Papritur si pronar u paraqit ‘Ibër-Lepenci’. Ne nuk ndodhemi fare në brezin ujor. Edhe nëse do të ishim, do të paguaja qira dhe tatime. Kam paguar edhe energjinë elektrike. Sipas ligjit, toka mund të jepet me qira dhe pikërisht këtë kemi kërkuar”, tha Mihajloviq më 21 korrik.

Ai tregoi se së bashku me pronarët e tjerë të shtëpive, kryesisht serbë nga veriu i Kosovës, kanë paraqitur ankesë tek Avokati i Popullit dhe në Gjykatën Themelore në Mitrovicë. “S’është mbajtur asnjë seancë. Kërkuam pezullim të përkohshëm të rrënimin, por ende nuk ka vendim”, deklaroi ai.

Liqeni i Ujmanit ndodhet në komunën e Zubin Potokut, në veriu të Kosovës, të banuar me shumicë serbe. Ai konsiderohet infrastrukturë strategjike për Kosovën, pasi shërben për furnizimin me ujë, prodhim të energjisë elektrike dhe ujitje.

Që nga viti 2024 autoritetet në Kosovë kanë nisur mbylljen e institucioneve serbe, duke i cilësuar ato si paralele dhe të paligjshme. Veprimet e Qeverisë së Kosovës në veri shpesh janë përballur me kritika nga faktori ndërkombëtar.

BORDI I AKK-së KËRKON MBROJTJEN E BUXHETEVE, PRONËS DHE AUTONOMISË SË KOMUNAVE

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 22 KORRIK - Bordi i Asociacionit të Komunave të Kosovës në takimin e fundit ka shqyrtuar sfidat kryesore financiare dhe ligjore me të cilat po përballen komunat. Bordi shprehu shqetësim për tërheqjen e rreth 60 milionë eurove nga buxhetet komunale përmes vendimeve gjyqësore dhe përmbarimore. Gjithashtu, u diskutua barra e mundshme prej rreth 60 milionë eurosh nga zbatimi i normës prej 0.5 % për përvojën e punës si dhe mungesa e financimit për rreth 3 100 mësimdhënës, me kosto të

vlerësuar prej 24 milionë eurosh në vit.

Bordi kundërshtoi zvogëlimin e Grantit të Performancës Komunale nga 4 milionë euro, të parapara me Ligjin për Ndarjet Buxhetore, në vetëm 2 milionë euro dhe kërkoi shpërndarjen e plotë të mjeteve për komunat përfituese. Po ashtu, u diskutua moskompensimi i dëmeve të shkaktuara nga reshjet dhe vërshimet që nga viti 2022 e tutje.

Bordi kërkoi nga qeveria që, pa vonesa të mëtejshme, ta bëjë kompensimin e dëmeve për qytetarët dhe komunat e prekura.

Gjatë shqyrtimit të Projektligjit

për Pronën Publike, Bordi kundërshtoi dispozitat që parashohin kalimin e pronës së pronës komunale te shteti, heqjen e mundësisë së këmbimit të pronës dhe kushtëzimin e vendimeve komunale me pëlqimin e institucioneve qendrore.

U vlerësua se këto propozime cenojnë kompetencat dhe autonominë e komunave dhe bien ndesh me parimet e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale.

Bordi kërkoi që AKK-ja t'i vazhdojë veprimet institucionale dhe ligjore për mbrojtjen e interesave financiare, pronësore dhe kushtetuese të komunave.



Kusari-Lila: Mbrojtja e konsumatorëve mbetet prioritet, nga muaji gusht do ta shtojmë numrin e inspektorëve

PRISHTINË, 22 KORRIK - Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit, Mimoza Kusari-Lila, ka thënë se mbrojtja e konsumatorëve mbetet një nga prioritetet kryesore. “Për këtë arsye, jemi të përkushtuar jo vetëm në forcimin e mbikëqyrjes së

tregut, por edhe në rritjen e kapaciteteve të Inspektoratit Qendror të Mbikëqyrjes së Tregut. Duke filluar nga muaji gusht do ta shtojmë numrin e inspektorëve, duke e rritur atë në 43 inspektorë nga 25 sa janë aktualisht. Ndërsa synimi ynë është që deri në fund të vitit ta

rritim këtë kapacitet në 100 inspektorë të tregut, për të garantuar mbrojtje edhe më efektive të qytetarëve nga manipulimet, mashtrimet dhe shkeljet në treg”, ka thënë ajo. Kusari-Lila ka falënderuar inspektorët e IQMT-së për përkushtimin dhe angazhimin

e tyre, veçanërisht në një periudhë kur intensiteti i inspektimeve ka qenë shumë i lartë. Ajo ka thënë se puna e tyre nuk do të ndalet. “Inspektimet vazhdojnë çdo ditë në mbrojtje të konsumatorëve dhe për zbatimin e ligjit”, ka thënë Kusari-Lila.



BASHKËTHEMELUESIT E AKB-së: KOSOVA NUK MUND TË KETË ZHVILLIM EKONOMIK DHE INTEGRIM EVROPIAN PA INSTITUCIONE FUNKSIONALE

PRISHTINË, 22 KORRIK - Bashkëthemeluesit e Aleancës Kosovare të Bizneseve (AKB) vlerësuan se Kosova ka nevojë urgjente për institucione funksionale, stabilitet politik dhe partneritet të qëndrueshëm me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimin Evropian, si parakushte për zhvillim ekonomik të qëndrueshëm, rritje të investimeve dhe avancim të proceseve integruese. Kryetari dhe bashkëthemeluesi i Aleancës Kosovare të Bizneseve (AKB), Agim Shahini, ka zhvilluar të mërkurën në Prizren një takim me bashkëthemeluesit e AKB-së, në të cilin kanë diskutuar për zhvillimet socio-ekonomike dhe politike në Kosovë si dhe për ndikimin e trendëve globale në ekonominë dhe sigurinë e vendit. Në takim morën pjesë

bashkëthemeluesit Përparim Hoxha, Nexhat Hasani, Shpend Kallaba, Mustafë Neziri, Shemsi Dresha dhe Fadil Maxhuni. Të pranishmit zhvilluan një debat të hapur mbi sfidat me të cilat po përballlet Kosova dhe domosdoshmërinë e krijimit sa më parë të institucioneve të plota dhe funksionale. Pjesëmarrësit u pajtuan se pa institucione stabile, funksionale dhe me legjitimitet të plotë nuk mund të ketë zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, investime serioze, siguri juridike për bizneset dhe avancim të proceseve integruese drejt Bashkimit Evropian. Ata theksuan se zvarritja e krijimit të institucioneve dëmton besimin e investitorëve, ngadalëson reformat dhe pengon realizimin e potencialit ekonomik të vendit. Po ashtu, u vlerësua se Kosova ka arritur sukseset e saj falë



sakrificës së qytetarëve dhe mbështetjes së vazhdueshme të partnerëve ndërkombëtarë, në veçanti të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, si aleati strategjik i Kosovës, si dhe të Bashkimit Evropian dhe vendeve mike, të cilët kanë qenë dhe mbeten mbështetës të shtetndërtimit, demokracisë dhe zhvillimit ekonomik të

vendit.

Kryetari i AKB-së, Agim Shahini, theksoi se biznesi ka nevojë për stabilitet institucional, siguri juridike dhe vendimmarrje të shpejtë. "Pa institucione funksionale nuk ka ekonomi të fortë, nuk ka investime të reja dhe nuk mund të ecim me ritmin që kërkon integrimi evropian. Kosova duhet të ruajë

dhe ta forcojë partneritetin strategjik me ShBA-në dhe Bashkimin Evropian, sepse ky partneritet mbetet garancia më e madhe për zhvillimin ekonomik, demokracinë, sigurinë dhe të ardhmen euroatlantike të vendit", ka tha ai.

Bashkëthemeluesit e AKB-së ritheksuan gatishmërinë për të kontribuar me ekspertizën dhe përvojën e tyre në funksion të zhvillimit ekonomik të Kosovës dhe për krijimin e një klime më të favorshme për bizneset vendore dhe investitorët e huaj. Në përfundim, Aleanca Kosovare e Bizneseve u bënë thirrje të gjitha forcave politike që, përtej dallimeve partiake, të veprojnë me përgjegjësi për krijimin sa më të shpejtë të institucioneve funksionale, në interes të qytetarëve, ekonomisë dhe të ardhmes evropiane të Republikës së Kosovës.

MINISTRIA E FINANCAVE NËNSHKRUAN GRANT PREJ 5 MILIONË EUROSH ME KFW PËR INVESTIME NË RRJETIN E TRANSMISIONIT

PRISHTINË, 22 KORRIK - Ministria e Financave ka nënshkruar marrëveshje granti në vlerë prej 5 milionë eurosh me Bankën Gjermane për Zhvillim (KfW), për financim shtesë të Projektit "Zhvillimi i sektorit të energjisë Faza VII - Përmirësimi i Rrjetit të Transmetimit", i cili do ta mbështesë realizimin e një sërë projekteve për zhvillimin dhe modernizimin e infrastrukturës së transmissioinit të energjisë elektrike në Kosovë. Projekti zbatohet nga Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të Energjisë Elektrike të Kosovës (KOSTT) dhe mbështet investimet që synojnë fuqizimin e infrastrukturës së transmissioinit, rritjen e sigurisë dhe besueshmërisë së



furnizimit me energji elektrike si dhe avancimin e integrimit të tregut energjetik. Investimi i mbështetur përmes këtij financimi paraqet një hap të

rëndësishëm në forcimin e kapaciteteve të sistemit energjetik dhe modernizimin e mëtejshëm të rrjetit të transmissioinit në vend.

Ministri i Financave, Hekuran Murati, vlerësoi angazhimin e KOSTT-it në zbatimin e projektit dhe rezultatet e arritura deri më tani, duke theksuar se ky financim shtesë i siguruar nga qeveria gjermane përmes KfW do ta mbështesë realizimin e investimeve prioritare dhe forcimin e qëndrueshmërisë së sistemit energjetik. Drejtori i KfW-së për Kosovë, Moritz Remé, theksoi rëndësinë e bashkëpunimit të vazhdueshëm me institucionet e Kosovës dhe konfirmoi gatishmërinë e KfW-së për ta vazhduar mbështetjen për modernizimin e sektorit energjetik në Kosovë. Kryeshefi ekzekutiv i KOSTT-it, Trim Tërnavë, theksoi se këto

projekte po realizohen sipas dinamikës së planifikuar, ndërsa mbështetja shtesë e siguruar nga KfW do të krijojë mundësi për modernizimin e mëtejshëm të rrjetit të transmetimit, duke rritur aftësinë e tij për t'iu përgjigjur zhvillimeve të së ardhmes dhe duke forcuar sigurinë dhe besueshmërinë e sistemit elektroenergetik të Kosovës. Ministria e Financave mbetet e përkushtuar për mobilizimin e financimeve për projekte strategjike që kontribuojnë në forcimin e sigurisë energjetike, zhvillimin e infrastrukturës kritike dhe avancimin e qëndrueshëm të sektorit të energjisë në Republikën e Kosovës.

"EKONOMIA PRIVATE E FINANCON SHTETIN", RAMOSAJ ME MESAZH TË DREJTPËRDREJTË PËR PUSHTETARËT

PRISHTINË, 22 KORRIK - Profesori i ekonomisë dhe ish-deputeti i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Berim Ramosaj, ka deklaruar se ekonomia private është baza që e mban dhe e financon shtetin. Në një diskutim në "Përballje Podcast" në "Telegraf", Ramosaj tha se historia e zhvillimit ekonomik dhe vetë mendimi ekonomik kanë dëshmuar rolin vendimtar të sektorit privat në funksionimin e një vendi. "Unë ende besoj se shtetin dhe ekonominë e një vendi e mban ekonomia private. Këtë na e kanë treguar edhe historia e zhvillimit ekonomik, por edhe zhvillimi i mendimit ekonomik", ka deklaruar

Ramosaj. Ai ka thënë se ekonomia private është burimi kryesor prej nga financohet buxheti i shtetit. "Privatët, ose ekonomia private, faktikisht e financojnë shtetin. Ekonomia publike nuk e financon shtetin, absolutisht", është shprehur ai. Sipas Ramosajt, taksat që paguhen nga bizneset dhe qytetarët mblidhen në buxhetin e shtetit, ndërsa institucionet publike kanë përgjegjësinë për t'i menaxhuar ato. "Këto taksa të privatëve mblidhen në një buxhet", ka thënë ai. Profesori i ekonomisë ka kritikuar mënyrën se si përfaqësuesit e institucioneve i paraqesin shpesh investimet



publike si arritje personale. "Kur del një kryetar komune dhe thotë: 'Unë po jua shtroj këtë rrugë', ose del kryeministri dhe

thotë: 'Unë po e bëj këtë rrugë apo këtë urë', kjo është dëshmi se ende nuk e kuptojmë jetën normale", ka deklaruar

Ramosaj. Ai ka theksuar se rrugët, urat dhe projektet e tjera publike nuk financohen me paratë personale të politikanëve, por me tatimet dhe taksat e qytetarëve dhe bizneseve. Sipas tij, politikanët nuk janë pronarë të parave publike, por vetëm menaxherë të mjeteve që u janë besuar nga qytetarët përmes votës dhe institucioneve. Ramosaj ka vlerësuar se sektori privat duhet të trajtohet si partner kryesor në hartimin e politikave ekonomike, pasi ai krijon vende pune, gjeneron të hyra dhe mban pjesën kryesore të barrës së financimit të shtetit.

ULIKSI, MENDIMTARI I PARË I PERËNDIMIT



Matt Damon dhe Zendaya në filmin "Odisea"

Në zanafillën e qytetërimit tonë, përtej luftëtarit dhe lundëtarit, qëndron një figurë që ushtron dyshimin dhe sfidon fatin. Uliksi tek Odisea e Nolanit është një filozof gënjeshtar: mashtron, por me gënjeshtër e tij kërkon lirinë. Gënjeshtër e Uliksit nuk janë lajmet e rreme të ditëve tona. Ato nuk synojnë të falsifikojnë botën për t'i penguar njerëzit ta kuptojnë atë, por janë "artefakte krijuese", me të cilat inteligjenca përpiqet ta përmirësojë realitetin kur ai, në të vërtetë e tij të zhveshur, bëhet i padurueshëm.

Lajmet e rreme të sotme e vrasin mendimin, sepse zhdukin dallimin midis së vërtetës dhe së pavërtetës dhe kërkojnë vetëm bindje të verbër. Përkundrazi, mashtrimet e zgjuara të Uliksit janë akte krijuese të mendjes së tij: ato hapin mundësi, shpikin rrugëdalje dhe e shndërrojnë një situatë pa shpresë në një hapësirë lirie.

Uliksi i Christopher Nolan lufton, vuan, vret dhe dashuron. Por, mbi të gjitha, ai mendon. Dhe kjo është befasia e vërtetë e filmit.

Skenat më spektakolare janë padyshim pushtimi i Trojës, i ndërtuar rreth shpikjes madhështore të kalit të Trojës, dhe masakra e përgjakshme e Pretendentëve, e rrëfyer si një larje hesapësh e prituri prej

njëzet vitesh. Megjithatë, të dyja marrin kuptim sepse Nolan tregon atë që vjen pas veprimit: heshtjen e ndërgjegjes.

Uliksi i tij nuk i kremton fitoret e veta, por mban mbi supë peshën e tyre, i torturuar nga pendimi për të vdekurit, nga malli për Itakën dhe nga dyshimi mbi kuptimin e zgjedhjeve të tij. Kështu, heroi shndërrohet në filozof.

Jo sepse ndërton një doktrinë, por sepse e bën reflektimin mbi jetën e vet qendrën e ekzistencës së tij. Në këtë mënyrë, Nolan rikthen rrënjën autentike të filozofisë greke, e cila nuk lindi si zotërim i së vërtetës, por si një kërkim i trazuar i urtësisë.

Këtë kërkim e udhëheq Athena, e interpretuar nga një Zendaya magjepsëse. Perëndesha nuk është vetëm mbrojtësja e heroit, por mishërimi i Sophia-s, urtësisë. Megjithatë, urtësia e saj nuk përputhet kurrë me një të vërtetë të dhënë njëherë e përgjithmonë. Athena shtron pyetje më shumë sesa jep përgjigje; e shoqëron Uliksin pa ia zëvendësuar lirinë; e detyron të vërë në pikëpyetje vetveten.

Filozofia shfaqet kështu si një dialog i përhershëm me dyshimin. Filozofi nuk është ai që e zotëron urtësinë, por ai që e do atë dhe vazhdon ta kërko-

jë.

Paradoksalisht, e vërteta i përket Kirkes, e interpretuar me një intensitet të jashtëzakonshëm nga Samantha Morton. Është ajo që flet me tonin e sigurisë. Por e vërteta e saj përputhet me fatin.

Kur ajo i shndërron shokët e Uliksit në derra, në të vërtetë nuk i ndryshon: ajo zbulon atë që ata kanë qenë gjithmonë. Metamorfoza nuk krijon një natyrë të re, por e bën të dukshme atë që ishte fshehur. Pikërisht ky është fati: të bëhesh në mënyrë të pashmangshme ai që je.

Dhe pikërisht këtu Uliksi largohet nga Kirkja dhe sfidon fatin.

Nëse fati flet gjuhën e së vërtetës, Uliksi zgjedh gjuhën e gënjeshtërës. Në disa skena të filmit, në dialogun me të riun Simone, personazh i shpikur nga Nolan, në debatet me shokët e tij dhe madje edhe në marrëdhënien me Telemakun, ai mbron hapur dobinë e gënjeshtërës. Jo si mashtrim për hir të mashtrimit, por si një mjet shpëtimi.

E gjithë jeta e Uliksit është ndërtuar mbi metisin, inteligjencën dinake që shpik strategji, maskime dhe identitete të rreme.

Kali i Trojës është një gënjeshtër gjigante. "Askushi", emri me të cilin mashtron Polifemin, është një gënjeshtër.

I rremë është plaku lypsar nën të cilin fshihet kur kthehet në Itakë. Të rreme janë rrëfimet që shpik për t'u shpëtuar armiqve dhe për të mbrojtur njerëzit e tij.

Por këto gënjeshtër nuk e shkatërrojnë realitetin: ato e shpëtojnë atë. Nuk e mohojnë jetën; i japin mundësi të vazhdojë.

Në leximin e Nolan-it, gënjeshtër nuk është e kundërta e së vërtetës morale. Ajo është e kundërta e fatalitetit. Nëse Kirkja përfaqëson fatin e pandryshueshëm, Uliksi përfaqëson lirinë krijuese të njeriut. Dinakëria e tij është aftësia për t'iu shmangur asaj që duket se është shkruar tashmë. Madje edhe identiteti nuk është një e dhënë e pandryshueshme: ai mund të fshihet, të rishpiket dhe të rifitohet. Njeriu është më shumë sesa natyra që i është atribuar, më shumë sesa fajet e tij, më shumë sesa e kaluara e tij. Kjo është një filozofi thellësisht perëndimore.

Që nga Sokrati e në vazhdim, kërkimi i vetvetes lind nga ushtrimi i dyshimit. Megjithatë, Nolan shton edhe një element tjetër: ky kërkim nuk ecën përpara vetëm përmes së vërtetës, por edhe përmes trillimit.

Imagjinata, rrëfimi, maskimi, madje edhe gënjeshtër, mund të bëhen mjete të lirisë, sepse


njeriu nuk jeton vetëm nga ajo që është, por edhe nga ajo që mund të bëhet ende. Kështu, udhëtimi merr një kuptim që shkon përtej kthimit në Itakë. Mbërritja nuk përkon kurrë me fundin e rrugës. Çdo arritje hap një pyetje të re; çdo siguri lind një nisje tjetër. Liria nuk qëndron te mbërritja, por te vazhdimi i zgjedhjes, pa asnjë garanci. Për këtë arsye, Nolan duket se shikon përtej Homerit. Ai shikon drejt Uliksit të Platonit dhe afrohet me Uliksin e fundit të Dantes, atë që nisjet sërisht drejt Perëndimit të panjohur për të ndjekur "virtytin dhe dijen".

Perëndimi lind pikërisht nga ky shqetësim i përhershëm: nga bindja se asnjë fat nuk mund ta shuajë dëshirën njerëzore për të njohur, krijuar dhe kapërcyer kufijtë e vet.

Në rrënjët e qytetërimit tonë nuk qëndron vetëm luftëtari fitimtar apo lundëtar i palodhur.

Qëndron një filozof që di të gënjejë: një njeri që reflekton mbi veprimet e veta, sfidon fatin me inteligjencë dhe parapëlqen rrezikun e lirisë ndaj sigurisë së domosdoshmërisë.

Kjo është ndoshta intuита më e guximshme e Christopher Nolan: t'ia ketë rikthyer Uliksit jo vetëm fytyrën e heroit, por edhe atë të mendimtarit të parë të madh të Perëndimit. / CDS – bota.al



**QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'**
TEL: 045/82 82 82

Klubi i Shigjetarisë Tradicionale në Prizren do ta përfaqësojë Kosovën në arenën ndërkombëtare

PRIZREN, 22 KORRIK - Klubi i Shigjetarisë Tradicionale në Prizren, anëtar i Federatës së Shigjetarisë së Kosovës, do ta përfaqësojë Kosovën në garat ndërkombëtare. Kjo është bërë me dije në një njoftim nga ky klub. Ata do të marrin pjesë në garën ndërkombëtare

Conquest Cup KKTC e cila do të mbahet në Lefkoshë, Qipro Veriore, nga 29 korriku deri më 3 gusht 2026. "Klubi ynë do të marrë pjesë në këtë garë me një delegacion të përbërë nga gjashtë sportistë dhe një trajner, të cilët do ta përfaqësojnë me krenari

Kosovën dhe vlerat e shigjetarisë tradicionale në arenën ndërkombëtare. Pjesëmarrja jonë në këtë aktivitet është një mundësi e rëndësishme për promovimin e sportit, kulturës dhe traditës sonë, duke forcuar njëkohësisht bashkëpunimin ndërkombëtar

në fushën e shigjetarisë. Një falënderim i veçantë shkon për YTB - Presidency for Turks Abroad and Related Communities, për mbështetjen e tyre të çmuar, e cila bëri të mundur pjesëmarrjen tonë në këtë aktivitet ndërkombëtar", është thënë në njoftim.



DRITA BARAZON NË MALTË NDAJ FLORIANAS, GJITHÇKA MBETET E HAPUR PËR NDESHJEN E KTHIMIT

FLORIANA, 22 KORRIK - Kampionia e Kosovës, Drita, ka nxjerrë një barazim 1:1 në përballjen e parë të rundit të dytë kualifikues të UEFA Conference League ndaj Florianas, në një ndeshje të zhvilluar në Maltë, e cila është karakterizuar edhe nga ndërprerjet e shumta për shkak të problemeve me energjinë elektrike.

Pjesa e parë është mbyllur pa gola, ndonëse të dyja skuadrat krijuan raste. Drita i është afruar golit me Vesel Limajn, ndërsa vendasve u është anuluar një gol

i Carlo Lonardellit për pozitë jashtë loje. Në pjesën e dytë takimi është ndërprerë tri herë pasi reflektorët e stadiumit janë fikur, duke shkaktuar vonesa në zhvillimin e ndeshjes.

Kur dukej se sfida do të përfundonte pa gola, Drita ka kaluar në epërsi në minutën e 96. Pas një asistimi të Blerim Krasniqit, Liridon Balaj ka realizuar gol me mjeshtëri, duke i dhënë avantazhin kampiones së Kosovës.

Megjithatë, epërsia e gjilanasve ka zgjatur vetëm pak minuta. Në



minutën e 102-të Amar Drina ka shënuar golin e barazimit për Florianan, duke vulosur rezultatin përfundimtar 1:1. Pavarësisht prej zhgënjimit për golin e pranuar në fund, Drita largohet nga Malta me një rezultat që e lë plotësisht të hapur çështjen e kualifikimit.

Ndeshja e kthimit do të zhvillohet pas një jave në stadiumin "Fadil Vokrri" në Prishtinë, ku Drita do të synojë ta sigurojë kalimin në rundin e tretë kualifikues të UEFA Conference League.

13 MILIARDË DOLLARË NGA NJË BOTËROR, FIFA GJEN "MINIERËN E ARIT" TË FUTBOLLIT

ZYRIH, 22 KORRIK - Kupa e Botës 2026 pritet të bëhet turneu më fitimprurës në historinë e futbollit, me FIFA-n që parashikon të ardhura rekord prej më shumë se 13 miliardë dollarësh gjatë ciklit të këtij Botërori. Parashikimi fillestar i FIFA-s ishte rreth 11 miliardë dollarë, por kjo shifër është tejkaluar tashmë, duke e kthyer edicionin e vitit 2026 në një rekord absolut financiar për organizatën më të lartë të futbollit botëror.

Rritja e të ardhurave lidhet kryesisht me zgjerimin e turneut në 48 skuadra, numrin rekord prej 104 ndeshjesh, interesin e jashtëzakonshëm global, si dhe çmimet më të larta të biletave krahasuar me edicionet e mëparshme.

Për krahasim, Botërori i vitit




2022 në Katar gjeneroi rreth 7.5 miliardë dollarë të ardhura, ndërsa edicioni i zhvilluar në ShBA, Kanada dhe Meksikë pritet të sjellë një rritje të ndjeshme financiare për FIFA-n. Por ambiciet ekonomike të organizatës nuk ndalen këtu. FIFA po shqyrton mundësinë e një zgjerimi të mëtejshëm për Kupën e Botës 2030, nga 48 në 64

skuadra, një ide që do të sillte më shumë ndeshje, më shumë tregje televizive dhe potencialisht edhe më shumë të ardhura. Nëse ky plan do të miratohet, Botërori do të shënonte një tjetër revolucion në format, duke e kthyer turneun më të madh të futbollit në një produkt ekonomik edhe më gjigant.

MESSI SHPALLET LOJTARI MË I MIRË I KUPËS SË BOTËS 2026

Lozanë, 22 korrik - Lionel Messi është shpallur lojtari më i mirë i Kupës së Botës 2026 nga Federata Ndërkombëtare e Historisë dhe Statistikave të Futbollit (IFFHS), duke marrë çmimin më të lartë individual të kësaj organizate për paraqitjet e tij gjatë turneut. Sipas IFFHS-së, fituesi është përcaktuar përmes një sistemi të detajuar vlerësimi që merr parasysh notat e ndeshjeve, golat, asistimet dhe ndikimin në fazën eliminatore. Pas analizës së të gjitha paraqitjeve në Botërorin 2026, Messi doli lojtari me indeksin më të lartë të performancës. Kapiteni i Argjentinës ka zhvilluar shtatë ndeshje në turne, duke luajtur 626 minuta. Ai ka realizuar tetë gola dhe ka dhuruar katër asistime, duke kontribuar drejtpërdrejt në 12 gola të kombëtares së tij. Mesatarja e vlerësimit të tij, sipas IFFHS-së,



ishte 8.33. IFFHS-ja ka theksuar se sistemi i saj i vlerësimit i kushton rëndësi të veçantë ndeshjeve të fazës eliminatore, ku ndikimi i Messit ishte vendimtar në rrugëtimin e Argjentinës deri në finale. Sipas federatës, çmimi është bazuar tërësisht në të dhënat statistikore dhe performancat e regjistruara gjatë turneut. Ky është një tjetër vlerësim prestigjioz në karrierën e Lionel Messit, i cili edhe në moshën 39-vjeçare vazhdon të jetë një nga futbollistët më dominues në skenën botërore.

Van Bommel zyrtarizohet trajner i Belgjikës

BRUKSEL, 22 KORRIK - Trajneri holandez ka nënshkruar kontratë deri në qershor të vitit 2028 dhe do të ketë objektiv kryesor drejtimin e "Djajve të Kuq" në

Kampionatin Evropian 2028. 49-vjeçari merr drejtimin e Belgjikës pas largimit të Rudi Garcias. Van Bommel vjen pas përvojave në pankinat e PSV

Eindhoven, Wolfsburg dhe Royal Antwerp, ku fitoi titullin kampion dhe Kupën e Belgjikës në vitin 2023. Federata Belge e Futbollit beson se ish-mesfushori i

Barcelonës, Bayern Munichut dhe Milanit është njeriu i duhur për ta udhëhequr brezin e ri të kombëtares belge në vitet e ardhshme.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Këshilli Prokurorial i Kosovës / Tužilački Savet Kosova / Kosovo Prosecutorial Council
Sekretariati / Sekretarijat / Secretariat



Në bazë të nenit 31 të Ligjit Nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, nenit 2 paragrafi 3, të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, nenit 18 dhe nenit 21 të Rregullores Nr. 08/2024 për Transferimin dhe Avancimin e Nëpunësve Civil në Administratën e Sistemit Prokurorial, Rregullores Nr. 03/2024 për Procedurën e Rekrutimit, Pranimit, Emërimit dhe Punës Provuese për të Punësuarit në Administratën e Sistemit Prokurorial, Rregullore Nr.02.2024 për Mandatin, Strukturën, Funkcionimin dhe Organizimin e ZMNV-së, Rregullore Nr.05.2026 për Klasifikimin e Vendeve të Punës të Administratës në Sistemin Prokurorial dhe në bazë të vendimit të Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës DPSKPK/Nr. 157/2026 të datës 17 prill 2026, Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës, shpall këtë:

KONKURS I BRENDSHËM
AVANCIM NË KARRIERË
Nr. 10/2026

I. Titulli i vendit të punës:	Udhëheqës i Zyrave Regjionale në ZMNV
Emërtimi i pozitës:	Drejtnes i Mesëm 2
Grupi, klasa, koeficienti/paga bazë:	P7 9.4
Institucioni/Njësia:	Zyra Qëndrore në kuadër të ZKPSH-së
Numri i pozitave	Një (1) pozitë
Kohëzgjatja e Emërimit:	Pa afat
Afati për aplikim:	23.07.2026- 29.07.2026

Përshkrimi i përgjithshëm i punës:

- Koordinon dhe mbikëqyr punën e udhëheqësve regional dhe mbrojtësve të viktimave/ përfaqësuesve të autorizuar për mbrojtje të viktimave;
- Bën hulumtimin e legjislacionit dhe praktikave të dobishme për çështje të ndryshme në fushën e mbrojtjes së viktimave të krimit në çështjet penale, administrative dhe civile;
- Ofron këshilla praktike dhe udhëzime të nevojshme juridike për udhëheqësit regionalë dhe, sipas nevojës, edhe mbrojtësve të viktimave/përfaqësuesve të autorizuar për mbrojtje të viktimave gjatë punës së tyre ditore;
- Në rast të mungesës së Koordinatorit të ZMNV-së apo përfundimit të mandatit të Koordinatorit, Udhëheqësi i Zyrave Regjionale ushtron të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë e Koordinatorit të ZMNV-së;
- Siguron bashkëpunim në mes të zyrave regjionale dhe zyrës qendrore të ZMNV-së;
- Inspektimin periodik të zyrave regjionale përfshirë inspektimin e lëndëve, seancave dhe mbarëvajtjen e punës së udhëheqësve regjionalë;
- Koordinon aktivitetet vetëdijesuese lidhur me të drejtat e viktimave të krimit në nivelin qendror;
- Harton raporte të rregullta, javore, mujore, tremujore dhe vjetore;
- Bën vlerësimin e udhëheqësve në nivel regjional;
- Udhëheqësi i Zyrave Regjionale në ZMNV i raporton Koordinatorit të ZMNV- së.

Kriteret e përgjithshme për pranimin në detyrë:

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë zotësi të plotë veprimi, sipas legjislacionit në fuqi;
- Të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- Të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse në pikëpamje shëndetësore;
- Të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje;
- Të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë;
- Të ketë arsimin, përvojën e punës profesionale dhe/apo aftësitë e kërkuara për pozitën, kategorinë, klasën apo grupin përkatës;
- Të kalojë me sukses procedurat e pranimit të përcaktuara në këtë rregullore.

Kriteret specifike shtesë, nëse ka:

- Nuk ka.

Njohuritë, aftësitë dhe cilësitë e kërkuara në procedurën e rekrutimit:

- Aftësi të larta organizative, drejtuese dhe aftësi për hartim politikash;
- Aftësi për t'iu përshtatur prioriteteve dhe kërkesave, afateve kohore përmes aftësive të nivelit të lartë analitik dhe zgjidhjes së problemeve;
- Njohuri të gjera lidhur me fushën e përgjegjësisë së njësisë; përkatëse, menaxhimin e buxhetit dhe të stafit administrativ;
- Aftësi komunikimi dhe bashkëpunimi, përfshirë aftësinë për të krijuar dhe mbajtur marrëdhënie mirëbesimi me eprorin dhe stafin që menaxhon;
- Aftësi për të motivuar stafin dhe për të menaxhuar me sukses projektet e njësisë përkatëse;
- Diplomë universitare - Fakulteti Juridik.
- Së paku pesë (5) vite përvojë pune profesionale.

Kriteret për avancim në karrierë të nëpunësit civil në sistemin prokurorial janë:

- Plotësimi i kërkesave profesionale dhe kualifikimet e kërkuara për pozitën përkatëse;
- Kalimi me sukses i testit me shkrim dhe intervistës;
- Rezultatet e vlerësimit në punë për tre (3) vjetët e fundit që duhet të jenë: arrin

- pritshmërinë, tejkalon pritshmërinë ose arritje e jashtëzakonshme;
- Të mos jetë në procedurë disiplinore;
- Të mos jetë i ndëshkuar me ndonjë masë disiplinore në tre (3) vjetët e fundit dhe
- Të mos jetë iniciuar ndonjë procedurë penale.

Dokumentet që duhet të dorëzohen si pjesë e aplikimit dhe mënyrën e dorëzimit të tyre:

- Kopjen e letërnjoftimit/pasaportës/certifikatës së shtetësisë së Republikës së Kosovës.
- Kopja e diplomës të kërkuar me konkurs dhe të dhëna nga institucionet arsimore, vërtetimin e nostrifikimit të diplomës së fituar jashtë vendit apo aktin që dëshmon se diploma e fituar jashtë vendit është në procedurë të nostrifikimit, me kusht që nostrifikimi i diplomës të dorëzohet deri në momentin e nënshkrimit të aktit për emërim në pozitë;
- Kopjet e dëshmisë se punësimit;
- Kopjet e dokumenteve që provojnë plotësimin e kushteve për aplikim, të përcaktuara në shpalljen e rekrutimit dhe të deklaruara në aplikacion.
- Aplikacioni se bashku me dokumente dorëzohen në mënyrë fizike, elektronike dhe përmes postës.

Dëshmitë që nuk kërkohen gjatë aplikimit, por në fazën e verifikimit para emërimit:

- Certifikatë mbi dënimet penale origjinale e lëshuar nga gjykata përmes së cilës dëshmohet se nuk është i/e dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje, jo më të vjetër se (6) muaj nga data e lëshimit.
- Dëshmi se kandidati është i aftë në pikëpamje shëndetësore.
- Dëshmi përkatëse se kandidati ka zotësi të plotë për të vepruar.

Mënyrën e vlerësimit të kandidatëve:

- Verifikimi paraprak.
- Vlerësimi profesional (testim me shkrim dhe intervistë).

II. Titulli i vendit të punës:	Udhëheqësi i Zyrës për Shërbime të Përgjithshme
Emërtimi i pozitës:	Drejtnes i ulët 1
Grupi, klasa, koeficienti/paga bazë:	P12 8.6
Institucioni/Njësia:	Zyra Qendrore në kuadër të ZKPSH-së
Numri i pozitave	Një (1) pozitë
Kohëzgjatja e Emërimit:	Pa afat
Afati për aplikim:	23.07.2026- 29.07.2026

Përshkrimi i përgjithshëm i punës:

- Udhëheq dhe përcakton objektivat e Zyrës për Shërbime të Përgjithshme, zbaton politikat dhe vendimet e miratuara nga Këshilli dhe ZMNV-ja, që përkojnë me fushë veprimtarinë e zyrës;
- Siguron, udhëheq, koordinon dhe mbikëqyrë logjistikën e nevojshme të ZMNV- së;
- Menaxhon pasurinë jo financiare të ZMNV-së, materialin shpenzues dhe depon. në ZMNV;
- Ofron mbështetje në hartimin dhe sigurimin e zbatimit të strategjive dhe planeve të veprimit të ZMNV që përkojnë me shërbimet e përgjithshme;
- Në bashkëpunim dhe koordinim me të gjitha njësitë e ZMNV identifikon dhe vlerëson nevojat brenda ZMNV-së;
- Menaxhon dokumentet zyrtare, siguron ruajtjen dhe arkivimin e dokumenteve përmes sistemeve përkatëse përfshirë edhe sistemin elektronik;
- Siguron dhe menaxhon shërbimet e përkthimit dhe lekturimit për ZMNV-në;
- Udhëheqësi i Zyrës për Shërbime të Përgjithshme i raporton Koordinatorit të ZMNV-së.

Kriteret e përgjithshme për pranimin në detyrë:

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë zotësi të plotë veprimi, sipas legjislacionit në fuqi;
- Të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- Të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse në pikëpamje shëndetësore;
- Të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje;
- Të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë;
- Të ketë arsimin, përvojën e punës profesionale dhe/apo aftësitë e kërkuara për pozitën, kategorinë, klasën apo grupin përkatës;
- Të kalojë me sukses procedurat e pranimit të përcaktuara në këtë rregullore.

Kriteret specifike shtesë, nëse ka:

- Nuk ka.

Njohuritë, aftësitë dhe cilësitë e kërkuara në procedurën e rekrutimit:

- Njohuri të gjera dhe të thella të politikave, legjislacionit, procedurave sipas veprimtarisë që mbulon njësia përkatëse.
- Aftësi organizative dhe drejtuese për të menaxhuar njësinë organizative.
- Aftësi për t'iu përshtatur prioriteteve dhe kërkesave, afateve kohore përmes aftësive analitike dhe zgjidhjes së problemeve.
- Aftësi komunikimi dhe ndikim personal, përfshirë aftësinë për të krijuar dhe mbajtur marrëdhënie besimi me eprorin dhe stafin që menaxhon.

5. Aftësi për të motivuar stafin dhe për të menaxhuar me sukses projektet e njësisë përkatëse.
6. Diplomë universitare - Fakulteti Ekonomik.
7. Së paku tri (3) vite përvojë pune profesionale.

Kriteret për avancim në karrierë të nëpunësit civil në sistemin prokurorial janë:

1. Plotësimi i kërkesave profesionale dhe kualifikimet e kërkuara për pozitën përkatëse;
2. Kalimi me sukses i testit me shkrim dhe intervistës;
3. Rezultatet e vlerësimit në punë për tre (3) vjetët e fundit që duhet të jenë: arrin pritshmërinë, tejkalon pritshmërinë ose arritje e jashtëzakonshme;
4. Të mos jetë në procedurë disiplinore;
5. Të mos jetë i ndëshkuar me ndonjë masë disiplinore në tre (3) vjetët e fundit dhe
6. Të mos jetë iniciuar ndonjë procedurë penale.

Dokumentet që duhet të dorëzohen si pjesë e aplikimit dhe mënyrën e dorëzimit të tyre:

1. Kopjen e letërnjoftimit/pasaportës/certifikatës së shtetësisë së Republikës së Kosovës.
2. Kopja e diplomës të kërkuar me konkurs dhe të dhëna nga institucionet arsimore, vërtetimin e nostrifikimit të diplomës së fituar jashtë vendit apo aktin që dëshmon se diploma e fituar jashtë vendit është në procedurë të nostrifikimit, me kusht që nostrifikimi i diplomës të dorëzohet deri në momentin e nënshkrimit të aktit për emërim në pozitë;
3. Kopjet e dëshmisë se punësimit;
4. Kopjet e dokumenteve që provojnë plotësimin e kushteve për aplikim, të përcaktuara në shpalljen e rekrutimit dhe të deklaruara në aplikacion.
5. Aplikacioni se bashku me dokumente dorëzohen në mënyrë fizike, elektronike dhe përmes postës.

Dëshmitë që nuk kërkohen gjatë aplikimit, por në fazën e verifikimit para emërimit:

- 1.Certifikatë mbi dënimet penale origjinale e lëshuar nga gjykata përmes së cilës dëshmohet se nuk është i/e dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje, jo më të vjetër se (6) muaj nga data e lëshimit.
- 2.Dëshmi se kandidati është i aftë në pikëpamje shëndetësore.
- 3.Dëshmi përkatëse se kandidati ka zotësi të plotë për të vepruar.

Mënyrën e vlerësimit të kandidatëve:

1. Verifikimi paraprak.
2. Vlerësimi profesional (testim me shkrim dhe intervistë).

Mënyrën e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët:

1. Përmes ueb faqes së institucionit në mënyrë elektronike;
2. Komunitetet jo shumicë dhe pjesëtarët e tyre, personat me aftësi të kufizuara dhe gjinia më pak e përfaqësuar kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në shërbimin civil të Kosovës, siç specifikohet në LZP;
3. Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen.
4. Kandidati përmes aplikacionit deklaron dhe mban përgjegjësi për vërtetësinë e të gjitha dokumenteve të dorëzuara siç kërkohen nga shpallja e procedurës së rekrutimit.
5. Deklarimi i rrejtshëm sipas këtij neni paraqet shkas për përjashtim nga procedura e rekrutimit.

Kandidatët që aplikojnë në dy apo më shumë pozita duhet që për secilën pozitë të dorëzojnë aplikacionin së bashku me dokumentacionin e duhur.

Konkursi është i hapur 5 ditë pune nga dita e publikimit në faqen zyrtare të Sistemit Prokurorial të Republikës së Kosovës, nga data **23.07.2026 deri më 29.07.2026**.
Aplikacioni së bashku me dokumentet mbështetëse mund të dorëzohet në Sekretariatin e Këshillit të formë fizike, përmes postës ose postës elektronike, i cili regjistrohet dhe secili kandidat pajiset me një konfirmim mbi pranimin e aplikacionit.

Aplikacionet dorëzohen çdo ditë pune nga ora 08:00 deri në ora 16:00, në Divizionin për Staf Administrativ, kati IV, objekti i Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, rruga “Luan Haradinaj”, 10000 Prishtinë, Kosovë si dhe përmes postes elektronike: burimet.njerezore@rks-psh.org

Aplikimi përmes postës: Aplikacionet e kompletuara me dokumente mund të dorëzohen edhe përmes postës në Departamenti i Burimeve Njerezore të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, adresa: Rr. “Luan Haradinaj”, kati i IV, objekti i Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës.

Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim, nëse arrijnë brenda 4 katër ditësh, aplikacionet që arrijnë pas këtij afati dhe ato të pakompletuara nuk do të shqyrtohen fare.

Në rast nevojë mund të na kontaktoni në, tel: 038/200 66048, 038/200 66029, 038/200 66051, 038/200 66028, prej orës 08:00 – 16:00.

Vetëm kandidatët që kanë aplikuar brenda afatit dhe që i kanë dorëzuar të gjitha dokumentet sipas konkursit kanë të drejtë t'i nënshtrohen procesit të avancimit. Ndërsa, kandidatët të cilët nuk kanë aplikuar brenda afatit të paraparë në konkurs, si dhe ata të cilët kanë aplikuar në afat, por nuk e kanë dorëzuar dokumentacionin e kompletuar sipas kriterëve dhe kërkesave të konkursit, nuk do të merren parasysh.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Këshilli Prokurorial i Kosovës / Tužilački Savet Kosova /
Kosovo Prosecutorial Council
Sekretariati / Sekretarijat / Sekretariat



Na osnovu člana 31. Zakona Br. 06/L-056 o Tužilačkom Savetu Kosova, člana 2. stava 3. Zakona Br. 08/L-197 o Javnim Službenicima, člana 2. stava 3. Zakona Br. 08/L-196 o Platama u Javnom Sektoru, člana 18. i člana 21. Pravilnika Br. 08/2024 o Premeštaju i Unapređenju Državnih Službenika u Administraciji Tužilačkog Sistema, Pravilnika Br. 03/2024 o Postupku Rekrutovanja, Prijema, Imenovanja i Probnog Rada Zaposlenih u Administraciji Tužilačkog Sistema, Pravilnika Br. 02/2024 o Mandatu, Strukturi, Funkcionisanju i Organizaciji KZPŽ-a, Pravilnika Br. 05/2026 o Klasifikaciji Radnih Mesta Administracije u Tužilačkom Sistemu i na osnovu odluke Generalnog Direktora Sekretarijat Tužilačkog Saveta prema OD STSK/Br. 157/2026 od 17. aprila 2026. godine, Sekretarijat Tužilačkog Saveta Kosova, objavljuje ovaj:

UNUTRAŠNJI KONKURS
UNAPREĐENJE U KARIJERI
Br. 10/2026

I. Naziv radnog mesta:	Šef Regionalnih Kancelarije u KZPŽ-a
Naziv pozicije:	Srednji Rukovodilac 2
Grupa, razred, koeficijent/osnovna plata:	P7 9.4
Institucija/Jedinica:	Centralna Kancelarija u sklopu KGDT-a
Broj pozicija	Jedna (1) pozicija
Trajanje imenovanja:	Neograničeno
Rok za prijavu:	23.07.2026. - 29.07.2026.

Opšti opis posla:

1. Koordiniše i nadgleda rad regionalnih rukovodilaca i branilaca žrtava / ovlašćenih zastupnika za zaštitu žrtava.
2. Sprovodi istraživanje zakonodavstva i korisnih praksi o različitim pitanjima u oblasti zaštite žrtava krivičnih dela u krivičnim, upravnim i građanskim stvarima;
3. Pružanje praktičnih saveta i potrebnih pravnih uputstava regionalnim rukovodiocima i, po potrebi, zastupnicima žrtava/ovlašćenim zastupnicima žrtava tokom njihovog svakodnevnog rada;
4. U slučaju odsustva koordinatora KZPŽ-a ili prestanka mandata koordinatora, šef regionalnih kancelarija obavlja sve dužnosti i odgovornosti koordinatora KZPŽ-a;
5. Osigurava saradnju između regionalnih kancelarija i centralne kancelarije KZPŽ-a;
6. Periodična inspekcija regionalnih kancelarija, uključujući inspekciju predmeta, seansi i napredak rada regionalnih rukovodioca;
7. Koordiniše aktivnosti podizanja svesti o pravima žrtava kriminala na centralnom nivou;
8. Izrađuje redovne, nedeljne, mesečne, kvartalne i godišnje izveštaje;
9. Ocenjuje rukovodioce na regionalnom nivou;
10. Rukovodilac regionalnih kancelarija u KZPŽ-a izveštava Koordinatoru KZPŽ-a.

Opšti kriterijumi za prijem na funkciju:

1. Da je državljanin Republike Kosova;
2. Da ima punu sposobnost delovanja, u skladu sa važećim zakonodavstvom;
3. Da tečno govori najmanje jedan od službenih jezika, u skladu sa Zakonom o Jezicima;
4. Da je u stanju izvršiti relevantni zadatak sa zdravstvene perspektive;
5. Da ne bude osuđivan za krivičnog dela sa predumišljajem;
6. Da nema na snazi disciplinske mere za ozbiljan prekršaj;
7. Da ima obrazovanje, profesionalno radno iskustvo i/ili veštine potrebne za odgovarajuću poziciju, kategoriju, klasu ili grupu;
8. Da uspešno prođe procedure prijema utvrđene ovim pravilnikom.

Dodatni specifični kriterijumi, ako ih ima:

1. Nema nijednog.

Znanja, veštine i kvaliteti potrebni u postupku zapošljavanja:

1. Visoke organizacijske, liderske i veštine kreiranja politika;
2. Sposobnost prilagođavanja prioritetima i zahtevima, rokovima putem visokorazvijenih analitičkih veština i veština rešavanja problema;
3. Opsežno znanje o području odgovornosti jedinice; upravljanje relevantnim, budžetskim i administrativnim osobljem;
4. Komunikacijske i veštine saradnje, uključujući sposobnost uspostavljanja i održavanja odnosa poverenja sa nadređenima i osobljem kojim upravljaju;
5. Sposobnost motivisanja osoblja i uspešnog upravljanja projektima relevantne jedinice;
6. Univerzitetska Diploma - Pravni Fakultet.
7. Najmanje pet (5) godina profesionalnog radnog iskustva.

Kriterijumi za unapređenje javnih službenika u tužilačkom sistemu su:

1. Ispunjavanje profesionalnih uslova i kvalifikacija potrebnih za odgovarajuću poziciju;
2. Uspešno položen pismeni test i intervju;

- 3. Rezultati procenjivanja učinka za posljednje tri (3) godine koji moraju biti: ispunjava očekivanja, premašuje očekivanja ili izuzetno dostignuće;
- 4. Da nije u disciplinskom postupku;
- 5. Da nije kažnjen/a bilo kakvom disciplinskom merom u posljednje tri (3) godine i
- 6. Da nije pokrenut nijedan krivični postupak.

Dokumenti koji se moraju dostaviti kao deo prijave i kako ih dostaviti:

- 1. Kopija lične karte/pasoša/uverenja o državljanstvu Republike Kosova.
- 2. Kopija diplome tražene konkursom i podaci od obrazovnih ustanova, potvrda o nostrifikaciji diplome stečene u inostranstvu ili akt kojim se dokazuje da je diploma stečena u inostranstvu u postupku nostrifikacije, pod uslovom da se nostrifikacija diplome dostavi do trenutka potpisivanja akta za imenovanje na poziciju;
- 3. Kopije dokaza o zaposlenju;
- 4. Kopije dokumenata kojima se dokazuje ispunjavanje uslova za prijavu, kako je navedeno u oglasu za zapošljavanje i navedeno u prijavi.
- 5. Prijava zajedno sa dokumentima se podnosi fizički, elektronski i poštom.

Dokazi koji nisu potrebni prilikom prijave, već u fazi provere pre imenovanja:

- 1. Originalna potvrda o krivičnim kaznama izdata od strane suda kojom se dokazuje da nije osuđen za počinjenje krivičnog dela s predumišljajem, ne starija od 6 (šest) meseci od datuma izdavanja.
- 2. Dokaz da je kandidat zdravstveno sposoban.
- 3. Relevantni dokazi da kandidat ima punu radnu sposobnost.

Način procenjivanja kandidata:

- 1. Preliminarna verifikacija.
- 2. Stručna procena (pismeni test i intervju).

II.	Naziv radnog mesta:	Šef Kancelarije za Opšte Usluge
	Naziv pozicije:	Mlađi rukovodilac 1
	Grupa, razred, koeficijent/osnovna plata:	P12 8.6
	Institucija/Jedinica:	Centralna Kancelarija u sklopu KGDT-a
	Broj pozicija	Jedna (1) pozicija
	Trajanje imenovanja:	Neograničeno
	Rok za prijavu:	23.07.2026. - 29.07.2026.

Opšti opis posla:

- 1. Vodi i određuje ciljeve Kancelarije za opšte usluge, sprovodi politike i odluke koje su odobrili Svet i KZPŽ, a koje se poklapaju sa područjem delovanja kancelarije;
- 2. Obezbeđuje, upravlja, koordiniše i nadgleda potrebnu logistiku KZPŽ-a;
- 3. Upravlja nefinansijskom imovinom KZPŽ-a, potrošnim materijalom i skladištima u KZPŽ-a;
- 4. Pruža podršku u izradi i osiguravanju sprovođenja strategija i akcionih planova KZPŽ-a koji se poklapaju sa opštim uslugama;
- 5. U saradnji i koordinaciji sa svim jedinicama KZPŽ-a, identifikuje i procenjuje potrebe unutar KZPŽ-a;
- 6. Upravlja službenim dokumentima, osigurava čuvanje i arhiviranje dokumenata putem relevantnih sistema, uključujući i elektronski sistem;
- 7. Pruža i upravlja uslugama prevođenja i lekturisanja za KZPŽ-a;
- 8. Šef Kancelarije za opšte usluge izveštava Koordinatoru KZPŽ-a.

Opšti kriterijumi za prijem na funkciju:

- 1. Da je državljanin Republike Kosova;
- 2. Da ima punu sposobnost delovanja, u skladu sa važećim zakonodavstvom;
- 3. Da tečno govori najmanje jedan od službenih jezika, u skladu sa Zakonom o jezicima;
- 4. Da je u stanju izvršiti relevantni zadatak sa zdravstvene perspektive;
- 5. Da ne bude osuđivan za počinjenje krivičnog dela s predumišljajem;
- 6. Da nema na snazi disciplinske mere za ozbiljan prekršaj;
- 7. Da ima obrazovanje, profesionalno radno iskustvo i/ili veštine potrebne za odgovarajuću poziciju, kategoriju, klasu ili grupu;
- 8. Da uspešno prođe procedure prijema utvrđene ovim pravilnikom.

Dodatni specifični kriterijumi, ako ih ima:

- 1. Nema nijednog.

Znanja, veštine i kvalitete potrebne u postupku zapošljavanja:

- 1. Široko i duboko poznavanje politika, zakonodavstva i procedura u skladu s aktivnošću koju pokriva odgovarajuća jedinica.
- 2. Organizacijske i liderske veštine za upravljanje organizacijskom jedinicom.
- 3. Sposobnost prilagođavanja prioritetima i zahtevima, rokovima kroz analitičke veštine i veštine rešavanja problema.
- 4. Komunikacijske veštine i lični uticaj, uključujući sposobnost stvaranja i održavanja odnosa poverenja sa nadređenima i osobljem kojim upravljaju.

- 5. Sposobnost motivisanja osoblja i uspešnog upravljanja projektima relevantne jedinice.
- 6. Univerzitetska diploma - Ekonomski fakultet.
- 7. Najmanje tri (3) godine profesionalnog radnog iskustva.

Kriterijumi za unapređenje javnih službenika u tužilačkom sistemu su:

- 1. Ispunjavanje profesionalnih uslova i kvalifikacija potrebnih za odgovarajuću poziciju;
- 2. Uspešno položen pismeni test i intervju;
- 3. Rezultati procene učinka za posljednje tri (3) godine koji moraju: ispunjava očekivanja, premašuje očekivanja ili izuzetno dostignuće;
- 4. Da nije u disciplinskom postupku;
- 5. Da nije kažnjen/a bilo kakvom disciplinskom merom u posljednje tri (3) godine i
- 6. Da nije pokrenut nijedan krivični postupak.

Dokumenti koji se moraju dostaviti kao deo prijave i kako ih dostaviti:

- 1. Kopija lične karte/pasoša/uverenja o državljanstvu Republike Kosova.
- 2. Kopija diplome tražene konkursom i podaci od obrazovnih ustanova, potvrda o nostrifikaciji diplome stečene u inostranstvu ili akt kojim se dokazuje da je diploma stečena u inostranstvu u postupku nostrifikacije, pod uslovom da se nostrifikacija diplome dostavi do trenutka potpisivanja akta za imenovanje na poziciju;
- 3. Kopije dokaza o zaposlenju;
- 4. Kopije dokumenata kojima se dokazuje ispunjavanje uslova za prijavu, kako je navedeno u oglasu za zapošljavanje i navedeno u prijavi.
- 5. Prijava zajedno sa dokumentima se podnosi fizički, elektronski i poštom.

Dokazi koji nisu potrebni prilikom prijave, već u fazi provere pre imenovanja:

- 1.Originalna potvrda o krivičnim kaznama izdata od strane suda kojom se dokazuje da nije osuđen za počinjenje krivičnog dela s predumišljajem, ne starija od 6 (šest) meseci od datuma izdavanja.
- 2.Dokaz da je kandidat zdravstveno sposoban.
- 3.Relevantni dokazi da kandidat ima punu radnu sposobnost.

Način procenjivanja kandidata:

- 1. Preliminarna verifikacija.
- 2. Stručna procena (pismeni test i intervju).

Način obaveštavanja i komunikacije sa kandidatima:

- 1. Elektronskim putem, putem web stranice institucije;
- 2. Nevećinske zajednica i njihovi članovi, osobe sa ograničenim sposobnostima i nedovoljno zastupljeni rod imaju pravo na pravednu i proporcionalnu zastupljenost u javnoj službi Kosovo, kao šta navedeno u ZJS;
- 3. Prijave podnesene nakon isteka roka neće biti prihvaćene, a nepotpune prijave će biti odbačene.
- 4. Kandidat, putem prijave, izjaavljuje i snosi odgovornost za autentičnost svih dokumenata dostavljenih kako je propisano oglasom za postupak zapošljavanja.
- 5. Lažna izjava prema ovom članu predstavlja osnov za isključenje iz postupka zapošljavanja.

Kandidati koji se prijavljuju za dve ili više pozicija moraju podneti prijavu za svaku poziciju zajedno sa odgovarajućom dokumentacijom.

Konkurs je otvoren 5 radnih dana od dana objavljivanja na službenoj web stranici Tužilačkog Sistema Republike Kosova, od **23.07.2026. do 29.07.2026.**
Prijava zajedno sa pratećom dokumentacijom može se dostaviti Sekretarijatu Saveta u fizičkom obliku, putem pošte ili e-pošte, što se evidentira i svaki kandidat dobija potvrdu o prijemu prijave.

Prijave se podnose svakog radnog dana od 08:00 do 16:00 časova, Departmanu za Administrationo Osoblje, IV sprat, zgrada Specijalnog Tužilaštva Republike Kosova, ulica „Luan Haradinaj“, 10000 Priština, Kosovo, kao i putem e-maila: burimet.njerezore@rks-psh.org

Prijava poštom: Popunjene prijave sa dokumentima mogu se dostaviti i poštom Departmanu za Ljudske Resurse Sekretarijata Tužilačkog Saveta Kosova, adresa: Ulica „Luan Haradinaj“, 4. sprat, zgrada Specijalnog Tužilaštva Republike Kosova.

Prijave poslate poštom, koje imaju poštanski žig poslednjeg dana roka za prijavu, smatrat će se važećim i biće razmotrene ako stignu u roku od 4 dana; prijave pristigle nakon ovog roka i nepotpune neće se uopće razmatrati.

Po potrebi nas možete kontaktirati na: tel: 038/200 66048, 038/200 66029, 038/200 66051, 038/200 66028, od 08:00 do 16:00 sati.

Samo kandidati koji su se prijavili u roku i koji su dostavili svu dokumentaciju u skladu sa konkursom imaju pravo da se podvrgnu procesu unapređenja. U međuvremenu, kandidati koji se nisu prijavili u roku predviđenom konkursom, kao i oni koji su se prijavili u roku, ali nisu dostavili kompletnu dokumentaciju u skladu sa kriterijima i zahtevima konkursa, neće biti uzeti u obzir.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, "FIDANI BETON" SH.P.K, Baballoq, Deçan, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Kompaninë "FIDANI BETON" SH.P.K, Baballoq, Deçan, për impiantin e riciklimit të mbeturinave inerte nga ndërtimi dhe demolimi, në Zonën Kadastrale Baballoq, Deçan.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 10.09.2026 në ora 10:00 në objektin e **Shkollës fillore të mesme e ulet "Dëshmorët e Baballoqit"**, do të organizohet debat publik nga "FIDANI BETON" SH.P.K, Baballoq, Deçan, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën online:

<https://us05web.zoom.us/j/7012651943?pwd=JsyiMPR68pjZDwwrm2Z53eU1x9TEbu.1>

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për "FIDANI BETON" SH.P.K, Baballoq, Deçan, për pëlqim për impiantin e riciklimit të mbeturinave inerte nga ndërtimi dhe demolimi, në Zonën Kadastrale Baballoq, Deçan.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin vnm.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, "Vëllezërit Geci" shpk., Skenderaj, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Kompaninë "Vëllezërit Geci" shpk., Skenderaj, për Pëlqim Mjedisor për projektin "Sistem Solar Fotovoltaik me kapacitet 5 MW" (2 MW mbi kulmin e objekteve ekzistuese dhe 3 MW në tokë), Kline e poshtme, Skenderaj.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 09.09.2026 në ora 14:00 në objektin e **Shkollës fillore të mesme e ulet "Shaban Jashari" Skenderaj**, do të organizohet debat publik nga "Vëllezërit Geci" shpk., Skenderaj, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën online:

<https://us05web.zoom.us/j/7012651943?pwd=JsyiMPR68pjZDwwrm2Z53eU1x9TEbu.1>

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për "Vëllezërit Geci" shpk., Skenderaj, për pëlqim për projektin "Sistem Solar Fotovoltaik me kapacitet 5 MW" (2 MW mbi kulmin e objekteve ekzistuese dhe 3 MW në tokë), Kline e poshtme, Skenderaj.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin vnm.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punës
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregatitje për intervistë



www.facebook.com/gjeipuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Saranda Gjonaj nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12.13 dhe diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Istref Hysni Nebiu shpall të pavlefshme Diplomën e Inxhinierit i Diplomuar i Makineris në UB-me nr. 332.

- Shkendije Lushaj nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m.l.m."Hysni Zajmi" Gjakovë.

- Maurita Koca nga Bishtazhina KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e kl.10 të Gjimnazit "Hajdar Duishi" Gjakovë.

- Bedri Zeneli nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 dhe diplomën dhe certifikatën e notave të Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit 2 të banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira në qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri në 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallën dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.

- Lëshoj banesën një dhomshe me qira, në lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroj i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.



ROYAL CROWN
RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

MEKA
®
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA

1992

